

**MYDERRIZ HAKI TAIP SERMAXHAJ,
BESNIK I KAUZËS KOMBËTARE**

*"Për atdhe duhet të flijojmë gjithka, pasurinë, evladët,
jetën.... Vetëm liria e atdheut i ka rrënjët në gjak dhe
vetëm sakrifica e bijve të tij e rrisin atë"*

Myderriz Haki efendi Sermaxhaj

Fetari më zëmadh, intelektual dhe patrioti i shquar i Anamoravës, Haki ef. Sermaxhaj, u lind në vitin 1914, në fshatin Hogosht të Dardanës (ish - Kamenicë). Ai rrjedh nga një familje përparimtare, arsimdashëse, dhe fetare islame. Hakiu, mësimet e para fetare i mori nga imamët e xhamisë të fshatit Hogosht, si: mulla Shaban Sermaxhaj (i afërm i familjes së tij) mulla Rexhep Vranja (personalitet fetar që kishte kryer studimet në Stamboll), e së fundmi edhe nga imami, atëherë i ri, mulla Idris Gjilani. Babai i tij, Taipi, ishte ithtar i flaktë i arsimit dhe i edukimit në gjuhën shqipe. Në atë kohë nuk funksiononte shkolla shqipe, prandaj Hakiune regjistroi në shkollën fillore serbe që në atë kohë funksiononte në fshatin e tij, në Hogosht. Hakiu shkollën fillore serbe e kreu me rezultate të shkëlqyera, duke qenë nxënësi më i mirë në shkollë.

Vendosmërinë për ta shkolluar të birin, Hakiun, babai i tij Taipi, e kishte dëshmuar edhe me deklaratën se: *"Po qe nevoja edhe shtëpinë kam me e shitur dhe nuk e lë pa e shkolluar Hakiun"*. Më vonë Hakiun e dërgon për shkollim të mëtejme në medresenë "Medah" në Shkup.

Pasi kreu mejtepin në Hogosht) ku për mësues kishte patriotin e njohur mulla Idris Gjilanin, vazhdoi shkollimin fillor, të cilin e kreu në vendlindje edhe atë në gjuhë serbe, me rezultate shumë të mira, në vitin 1925/26. Më pas, vazhdoi shkollimin në medresenë e njohur "Medah" të Shkupit, ku po ashtu për mësues kishte një patriot tjetër shqiptar, myderriz Atullah effendi Kurtishin (i cili ishte edhe rithemelues i medresesë "Medah") e të tjerë.

Medreseja “Medah” e Shkupit, në atë kohë (në kohën në mes të Luftërave Botërore, kur atë e drejtonte Atullah efendi Kurtishi) jo vetëm që ishte shkollë fetare, por ajo ishte erdhe e edukimit patriotik e atdhetar e të gjithë myslimanëve shqiptarë që e kryenin këtë medrese. E tërë kjo te Hakiu kishte lënë mbresa të pa shlyeshme në vetëdijen e tij prej një personaliteti me përcaktim të qartë fetar, politik, patriotik e atdhetar, gjë që e shtyu Haki Efendiun të rihapë medresenë “Atik” në Gjilan.

Medresenë “Medah” të Shkupit e mbaroi në vitin 1940 dhe kthehet menjëherë në Hogosht për pak kohë e për të vazhduar pastaj në Gjilan me shpërndarjen e diturisë që kishte fituar nga myderrizët e njohur të medresesë në zë, si Atullah effendi Kurtishi (i cili ishte edhe rithemelues i medresesë “Medah”) e të tjerë. Medreseja “Medah” e Shkupit jo vetëm që ishte shkollë fetare, por ajo ishte çerdhe e edukimit patriotik e atdhetar e të gjithë myslimanëve shqiptarë që e kryenin këtë medrese. E tërë kjo te Hakiu kishte lënë mbresa të pshlyeshme në vetëdijen e tij prej një personaliteti me përcaktim të qartë fetar, politik, patriotik e atdhetar, gjë që e shtyu Haki Efendiun të rihapë medresenë “Atik” në Gjilan, ndër medresetë e para në regjion (ndoshta edhe më gjerë), pasi ato ishin mbyllur nga mbretëria serbosllave. Autoriteti dhe ndikimi i Haki Efendiut mbetet i pamposhtur para armiqve, ndonëse PK (partia komuniste) dhe UDB-ja e kishin në listën e njerëzve të rrezikshëm. Kontaktet me të shpeshta të Haki Efendiut ishin me mulla Idris Gjilanin, mulla Hasanin nga Malisheva, Maliq Sahitin (ollaku), Rexhep Ibrahimin, Aqif Oranen, mulla Hysen Perlepnicen etj., me të cilët në dhomën e tij bisedohej për ështëje të shumta të fatit të atdheut. Dhoma e tij ishte bërë çerdhe e intelektualëve dhe e patriotëve shqiptarë për takime historike e kombëtare. Ishte gjithnjë në krye të organizimeve të natyrave të ndryshme, mbi të gjitha në krye të forcave vullnetare dhe dërgimin e tyre në mbrojtje të kufirit të Kosovës Lindore, madje edhe pjesëmarrës aktiv në aksione konkrete në vijë të frontit, në luftë kundër depërtimit të forcave partizano-çetnike në këto zona, të cilat jo vetëm i njihte, por edhe i drejtoi me sukses. Roli i tij, si ushtarak i formuar e si komandant, u ndie me tërë fuqinë gjatë kryerjeve të veprimeve, si ato të nivelit taktik, operativ, strategjik,

mobilizues, gjatë vitit 1944, në mbrojtje të kufirit lindor të Kosovës. Veprimtaria e tij ushtarake ishte në pajtim me programin e dalë nga Kuvendi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1943). Pas Luftës së Dytë Botërore, duke mos u pajtuar me riokupimin e sërishëm sllavo-komunist të viseve etnike shqiptare, Haki Efendiu do të gjendet në vorbullën e LpLTSH-së. (Lëvizja për Lirimin e Tokave Shqiptare), gjegjësisht në ONDSH dhe “Besa kombëtare”, që vepronin si organizata ilegale politike të organizuara mirë dhe të formuara në prag të përfundimit të Luftës II Botërore. Organizatat kishin degë të shtrira në të gjitha viset shqiptare të ish – Jugosllavisë. Këto lëvizje kishin program dhe aspirata kombëtare-politike me qëllim lirim dhe bashkimin e trojeve etnike shqiptare. Respektin dhe aftësitë që posedonte Haki Efendiu, dëshmohen edhe nga prania e tij në krye të KQ-së të NDSH-së për rrethin e Gjilanit për shpëtim dhe bashkim kombëtar.⁽¹⁾

Myderriz Haki Efendiu në medresenë “Atik” të Gjilanit futi për herë të parë edhe mësimin në gjuhën shqipe ku për mësimdhënës angazhoi mësuesit nga Shqipëria, si: Malo Becin, Hasan Dulgjerin e të tjerë. Myderriz në medresenë “Atik” ishte deri në vitin 1946 kur edhe e burgosin

për veprimtari armiqësore kundër shtetit sllavo-komunist dhe për angazhimin e tij për krijimin e Shqipërisë së Madhe. Haki Efendiu ishte bashkëpunëtor i ngushtë i mulla Idris Gjilanit, pastaj me mulla Riza Poliçkën-Shurdhanin, mulla Riza Marevcin, mulla Hysen Islam Zhujën (Osmanin), me hafëz Nexhatin e Preshevës, me të cilët përveç atdhedashurisë dhe kauzës kombëtare i lidhte edhe profesioni dhe feja, si dhe me Gjon Serreqin ishin lidhur në kuadër të lëvizjes NDSH në këto anë të Kosovës.

Hapja e medresesë “Atik” në Gjilan, aktiviteti i tij politikopatriotik, qenia dorë e djathtë e mulla Idris Gjilanit, me të cilin ishin të pa ndashëm në mbrojtje të kufirit lindor shqiptar të Kosovës me Serbinë, bënë që regjimi i atëhershëm të mos e shikonte me sy të mirë dhe prej këtu edhe filluan përndjekjet, keqtrajtimet e më vonë edhe burgosjet e myderriz Haki Efendiut.

Përkundër kësaj, ai i kishte vënë detyrë vetes si dhe ishte betuar se tërë jetën do t’ia kushtonte shkollimit, edukimit fetar si dhe lirit të atdheut. Këtë e kishte edhe porosi nga mësuesi i tij

¹ Musafir-vizitor: Myderriz Haki Sermahaj (1914-1948) bot. më 31 gusht 2008.

Atullah efendi Kurtishi, i cili para se të ndërronte jetë kishte lënë një amanet për nxënësit e tij, që të mos i braktisin trojet e tyre, të cilat me gjak i kishin mbrojtur gjyshërit e stërgjyshërit.

Ixhazetname (faqja e parë dhe e fundit) e Haki Efendiut

Myderriz Haki Efendiu në medresenë "Atik" të Gjilanit, futi edhe mësimin në gjuhën shqipe. Pas kësaj, myderriz Haki Efendiu gjithmonë ishte në ndjekje nga çdo regjim pushtues. Menjëherë pas ardhjes në pushtet, regjimi komunist e burgosi atë në gusht të vitit 1946, prej nga nuk do të lirohej kurrë.

Burgosja e Haki Efendiut në gusht të vitit 1946 bëri bujë të madhe te popullata e kësaj ane. Kur ai u transferua nga burgu i Gjilanit në atë të Ferizajt e më pas në atë të Idrizovës në Kalanë e Shkupit u shoqërua me një ngjarje. Këtë e tregon i biri z. Irfan, i cili e kishte dëgjuar nga kalimtarët e rastit që e kishin parë internimin e myderriz Haki Efendiut për në burgun e Idrizovës. Njëri nga qytetarët (me kombësi serbe), i cili e kishte njohur Haki Efendiu, i kishte pyetur bashkëqytetarët e bashkëkombasit e tij: "A ju ka dhimbsur Hakiu?", - duke mos pritur përgjigjen e tyre kishte theksuar vetë: "Jo, jo pak ju paska dhimbsur ai ju, pasi që ju pak bëtë për të".

Për myderriz Haki Efendiu ishte fatal qëndrimi i tij në burgun e Idrizovës në Kalanë e Shkupit. Këtu, keqtrajtimet, dhuna dhe torturat në qeli nuk iu ndalën për 52 ditë radhazi.

Gjatë kësaj periudhe, ai u sëmur rëndë nga tuberkulozi, sa që edhe kur erdhi dita e gjykimit ai ishte i shtruar në spital.

-Ishte dënuar me vdekje, - tregon djali i tij Irfani, - por me që ishte i sëmurë rëndë atë dënim ia kishin zbutur me dënimin prej 20 vjet burgim, heqje lirie.

Menjëherë e dërguan në vuajtje të dënimit nëpër kazamatet jugosllave, si në burgun e Nishit, Beogradit për të përfunduar në burgun e Mitrovicës së Sremit në vitin 1947.

Myderriz Haki Efendiu, një javë para vdekjes, u kishte lënë amanet shokëve të tij në burgun e Mitrovicës së Sremit s: "Për atdhe duhet të flijojmë gjithka, pasurinë, evladët, jetën.... Vetëm liria e atdheut i ka rrënjët në gjak dhe vetëm sakrificat e bijve të tij e rrisin atë".

Myderriz Haki Efendiu ishte njëri ndër kolosët fetarë të regjionit të Anamoravës, kishte një edukatë të lartë fetare, i devotshëm, njeri i arsimuar, intelektual, human, trim, atdhetar e patriot i shquar, i cili një jetë të tërë ia kushtoi dhe e flijoi për lirinë e atdheut.

Qëndroi në burg deri në fund të jetës së tij në vitin 1948, në burgun e Mitrovicës së Sremit, kur edhe ndërroi jetë, duke mos mundur t'u bëjë ballë keqtrajttimeve, rrahjeve dhe në fund edhe mbytjes nga regjimi sllavo-komunist.

Ndërroi jetë në burgun famëkeq të Mitrovicës së Sremit dhe u varros pa e lajmëruar fare familjen e tij. As sot e kësaj dite myderrizit Haki efendi Sermaxhaj nuk i dihet varri. Edhe pas gati shtatë dekadave, vdekja e tij mbetet ende enigmë e pazbardhur.

Pas mbytjes së myderris Haki ef. Sermaxhaj në burgun e Mitrovicës së Sremit, pothuajse gjatë gjithë regjimit serbosllav komunist, familjes së të ndjerit e sidomos djalit të madh të Hakiut, Irfanit, nuk iu ndalën hallet. Presionet dhe bisedat –intervista nga inspektorët e UDB-së nuk kishin të mbaruar, sikurse që nuk kishin të ndalur edhe përjashtimet nga marrëdhënia e punës sapa ai punësohej në ndonjë shkollë apo institucion tjetër në sistemin komunist.

Përveç kësaj, familjarët nuk kanë shfrytëzuar edhe ato pak përfitime (qofshin ato morale apo materiale) që ju takojnë atyre, së paku për t'i shfrytëzuar që të realizonin kthimin e eshtrave të tij në vendlindje dhe të përmbushin kështu një amanet të tij. Është koha që për myderrizin Haki Efendiu të bëjmë dika më shumë, sepse përvjetorët e tij të lindjes dhe të vdekjes kalojnë një nga një, por për Haki efendiun asgjë e re. Ka ardhur koha për një tubim përkujtimor për këtë atdhetar, (dhe jo vetëm për të). Është momenti që tani të ndërmerret iniciativa për kthimin së paku të eshtrave të këtij kolosi në Kosovë. Do e kishim plotësuar me këtë së paku një amanet të tij. Dhe jo vetëm ndaj këtyre dy dëshmorëve të lirisë që i përmendëm, por edhe ndaj të gjithë dëshmorëve të tjerë, ka ardhur koha t'i nderojmë ashtu siç e meritojnë. Kështu na lind pyetja se, a thua ne jemi duke i përkrahur, përkujtuar dhe ngritur lart emrat e tyre me punën tonë të përkushtuar, për gjithë atë që kanë dhënë e sakrifikuat ata për lirinë

Atdhetarë të tillë, si mulla Idriz Gjilani e Haki efendi Sermaxhaj, që i ka njohur e nderuar e gjithë bota shqiptare, meritojnë edhe më shumë se sa të përmenden në këtë shkrim. Gjithsesi, ky shkrim, shpresojmë të shërbejë si kujtesë për ata që e kanë për detyrë dhe obligim për të ndërmarrë dika më konkrete në këtë drejtim.

Myderriz Haki efendi Sermaxhaj, asnjëherë nuk u pajtua me pushtuesit dhe me qëndresën e tij heroike vazhdoi luftën kundër regjimit (pushtuesve) serbosllav në kohën e Mbretërisë Serbe të mbretit Aleksandër, dhe po kështu ndaj regjimit komunist të Titos, duke mbetur gjithmonë kryelartë, ballëhapur, sypatrembur e besnik i kauzës kombëtare për lirin e vendit deri në fund të jetës së tij.

Kohë më parë, më 08.05.2017, me dekretin nr. 10295, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, Haki efendi Sermaxhajin e dekoroi me "DEKORATËN E ARTË TË SHQIPONJËS", "Për kontributin e shquar në ështëjen kombëtare shqiptare duke iu përkushtuar shkollimit dhe edukimit në gjuhën shqipe, si edhe për qëndrimin e papërlur në burgjet jugosllave, deri në flijim".

Bibliografia

- Disa të dhëna na i tregoi (gojarisht)djali i madh i myderriz Haki Efendiut, z. Irfan Sermaxhaj.
- Pjesë nga libri i Islam Osmanit, i cili së shpejti pritet të botohet: *Imamët e Gjilanit 1912-2015*.
- Mr. Aliriza Selmani, Hafëz Avni Aliu: *Myderriz Haki Efendiu (1914-1948)*, Prishtinë, 2005.
- Xhemush Biku *Xhamitë dhe imamët e Dardanës me rrethinë 1532-2004*, f.72.